

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË SHKODËR 2024

**PËRGATITUR NGA:
INTELEKTUALËT E RINJ SHPRESË (IRSH)
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE**

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Shkodër

Përgatiti: Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	2
1. LISTA E SHKURTIMEVE	3
2. HYRJE	4
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	6
4. METODOLOGJIA E STUDIMIT	7
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	9
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË SHKODËR:	11
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË SHKODËR	12
8. VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	14
8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË SHKODËR	17
8.2 GJETJE NGA INTERVISTAT E ZHVILLUARA ME ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK	18
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIC	19
9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	19
9.2 PERCEPTIMI QYTETAR (PYETËSORI ONLINE)	20
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	21
11. REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN)	23
12. ANEKSE	24
ANEKSI 1. KËRKESA DREJTUAR BASHKISË SHKODËR	24
ANEKSI 2. PYETËSORI PËR INTERVISTAT E THELLUARA ME STAFIN E BASHKISË	24
ANEKSI 3. PYETËSORI PËR INTERVISTAT E THELLUARA ME PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT BASHKIAK	24
ANEKSI 4. PYETËSORI PËR GRUPET E INTERESIT	24
ANEKSI 5. PYETËSORI ONLINE PËR QYTETARËT	24

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
IRSH	Intelektualët e Rinj Shpresë
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën dhe krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interes dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financiar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën prill – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara² për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popNetwork.al/>

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të ligjit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij.

Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

<ul style="list-style-type: none"> • Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë; • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; • Qendra Rinore Vlorë, • Epoka e Re, Fier; 	<ul style="list-style-type: none"> • Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; • Qendra Rinore për Progres, Kukës, • Gruaja në Zhvillim, Korçë; • Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; • Tjetër Vizion, Elbasan
--	---

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Shkodër, studimi është përgatitur nga shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Shkodër” vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësive publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik³ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Shkodër, duhet të demonstrojnë përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre me efikasitet, efektivitet dhe transparencë, në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Ndërkohë, komuniteti dhe veçanërisht shoqëria civile, nga ana e tyre, duhet të përfitojnë dhe përdorin me mençuri këto mekanizma, duke ushtruar rolin e tyre të domosdoshëm dhe fuqinë që ligji iu jep në sigurimin e një qeverisjeje të drejtë, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit.

Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debati i hapur, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve të ndryshme, si dhe shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, duhet të jenë reale dhe jo sa për procedurë dhe fasadë, e duhet të realizohet në të gjitha fazat që ligji parashkon, duke mundësuar një vendimmarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse për çdo bashki.

³ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qgz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

Njohja dhe zbatimi efektiv i ligjit, synon të sigurojë transparencën e munguar prej vitesh, ndaj vendimarrjes së KB dhe të bashkisë, të cilët zakonisht i konsiderojnë dëgjesat publike e konsultimet me publikun, si procese që duhen bërë sa për të qënë në rregull me ligjin, e në më të shumtën e rasteve i anashkalojnë gjithë fazat e dispozitave normative, duke lënë mënjanë dhe duke përjashtuar qytetarët dhe palët të tjera të interesuara (OSHC-të), duke zvogëluar ndjeshëm hapësirat e pjesëmarrjes e për pasojë vendimet që zbatohen bëhen më të vështira për tu pranuar nga të gjithë aktorët e komunitetit.

Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese si dhe në ato raste kur raportojnë që kanë qënë pjesë e tyre, ata pohojnë se zëri i tyre nuk dëgjohet, ose mjaft rekomandime nuk gjejnë zbatim.

Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, vëmë re se ligji njihet dhe zbatohet në mënyrë modeste nga ana e aparatit ekzekutiv (stafi i bashkisë) ashtu dhe nga legjislativi (anëtarët e KB)

Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë dhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale.

Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik duke përcaktuar qartë se cilat projekt akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor, duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Gjithësesi grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktivë në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke njohur të drejtat e tyre, për të ushtruar presion pozitiv dhe për tu ankuar pranë institucioneve përgjegjëse e duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me interes të lartë publik.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁴) në Bashkinë Shkodër, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjeteve dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.⁵
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

⁵ Raporti Studimor përgatitur nga IRSH 2022: <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-shkoder/>

Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.

- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë, gjithsej tetë(8).
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 5 intervista të drejtpërdrejta me stafin e bashkisë (Nën kryetar/e i/e bashkisë; Koordinator/i ja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Koordinator/i ja për të Drejtën e Informimit dhe Transparencën; Drejtoria Juridike; Drejtoria e Financës, etj) si edhe 6 intervista të thelluara me anëtarë të këshillave bashkiakë (Kryetar, sekretar i KB, anetar i komisionit juridik, anëtar i komisionit të financës, anëtar i komisionit të peticioneve, mandateve dhe rregulloreve). 30 (17F/13M) intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (15 intervista me OJF, Biznese, aktiviste te shoqerise civile dhe 15 te tjera me qytetare nga grupet e interesit); 104 (63F/41M) pyetësorë online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.
- Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkisë e këshillave bashkiakë të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile, etj.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale. Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë, intervista drejtuar stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, sekretarët e këshillave bashkiakë stafet e bashkive dhe aktivistë qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve.

Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në regjistrin elektronik.

Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse. Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar.

Për përgatitjen e pyetësorëve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës

dhe çështjeve. Gjithashtu trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokalë, për të zhvilluar intervistat në terren.

Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët. Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar.

Shoqata "Intelektualet e rinj, Shprese" përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe Këshilli Bashkiak).

Ky raport studimor është një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen publike, duke synuar një qeverisje më të hapur, transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Shkodër.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër është hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁶ dhe sekondare⁷ për grumbullimin e informacionit. Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndër marrin në lidhje me zbatimin e ligjit për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithpërfshirës

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në Bashkinë Shkodër i Ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" dhe Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimarrje që ato kryejnë.

Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".
- Ligji Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar.

⁶ Si burimë primare të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", informacioni në lidhje me procesin e konsultimi public të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfutur nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁷ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

- Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”
- VKM nr. 653/2016 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar"
- VKM nr. 828/2015 "Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike"

Duke iu referuar ligjit organik për Vetëqeverisjen Vendore Nr.139/2015, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁸ të tyre në procesin e vendimmarrjes. Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që I përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ai përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Transparenca është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese. Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike” është nje akt nenligjor me rendesi, qe parashikon krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) dhe publikimin e tij në formën e një portali elektronik, faqeje web-i, me adresë elektronike: <http://www.konsultimi publik.gov.al>

⁸ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në Bashkinë Shkodër:

Informacion i përgjithshëm:

Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër ka një sipërfaqe prej 873 km² dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (**Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postrinë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë**). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra. Qyteti Shkodër është njësi administrative qendër e Bashkisë.

Demografia Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njësi administrative, njësi me popullsi më të madhe është ajo e rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postrina me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Punesimi: Numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 25,058 persona, nga të cilat: 28 % në sektorin publik; 72 % në sektorin privat. Totali i bizneseve në Bashkinë Shkodër është 5,593 nga të cilat: 1,470 janë biznese të mëdha 4,069 janë biznese të vogla dhe 54 institucione.

Këshilli Bashkiak Shkodër, është organi përfaqësues i bashkisë Shkodër, i cili përbëhet nga 51 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 27 M/24 F anëtarët e KB kanë ngritur 16 komisione. Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes rregulloreve të brendshme të miratuara si më poshtë:

- *Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër.*

E miratuar në mbledhjen e KB Shkodër më 28.12.2020⁹, me vendim nr.60. Duke shqyrtuar këtë rregullore e cila është e ngarkuar në faqen e internetit vëmë re se KB ka disa të drejta dhe detyrime për të organizuar njoftimin dhe konsultimin publik (neni 93 e vijues) në marrëdhënie me grupet e interes dhe qytetarët e NJVQV-së.

*Nderkohe ne seksionin e Keshillit Bashkiak Shkodërfiguron Projekt-Akti "Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat"*¹⁰. Kjo draft-rregullore e iniciuar nga projekti Bashki te Forta vazhdon të mbetet e pa miratuar ndonese eshte hartuar qe ne vitin 2019!

Së fundmi Keshilli Bashkiak Shkodërme vendimin nr.29, date 29.04.2024 ka miratuar "Programin e Transparences ne Bashkine Shkoder"¹¹, një dokument i rëndësishëm që pritet të përmirësojë

⁹https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_funksionimit_t_k_shillit_bashkiak_shkoder_4406.pdf

¹⁰ https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_keshillit_marr_dh_njet_me_publicun_konsultim_dhe_median_final_4387.pdf

¹¹ <https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/vkb-29-.pdf>

ndërveprimin me qytetarët, më specifikisht, bazuar në detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.146/2014 ku parashikon informacionin dhe proceduart e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ku përfshihen informacione në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare. Ky program parashikon bashkëpunimin e Këshillit Bashkiak dhe bashkisë Shkodër.

Për efekt të studimit më poshtë po rendisim disa prej proceduarve dhe projektakteve ku bashkia e Shkodrës dhe KB janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- *Konsultimet me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”*
- *Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.*
- *Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te version final të programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 Qershor – 30 Shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 Shtatori – 30 Nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.*
- *Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.*
- *Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.*
- *Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet ti nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.*
- *Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, psh rrugë publike, parqe eolike, landfill, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve*

7. Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër

Për herë të parë shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” (IRSH) publikoi në muajin Prill 2016, Raportin e parë mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër i cili fokusohet në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” si dhe në zhvillimin e procesit të konsultimit publik në zbatim të ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”¹². Nga komunikimet zyrtare me Bashkinë Shkodër nuk rezultonte se ekzistojnë plane vjetore të Bashkisë Shkodër që lidhen me procesin e vendimarrjes. Po ashtu rregjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike të projektakteve ku mund të konsultohen të dhënat dhe projektaktet si një mundësi komunikimi për të gjitha palët e interesuara të nderveprojnë me organin publik nuk parashikon mënyrën sesi

¹² <http://irsh.al/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-Transparences-Shqip.pdf>

keto palë mund të komunikojnë apo të dërgojnë komentet dhe rekomandimet e tyre. Po ashtu kordinatori per konsultimin publik nuk ishte emeruar ende dhe procesverbalet e takimeve nuk mbahesh ne formen e duhur ligjore. Po ashtu ne njoftimet e Bashkisë Shkodërnuk parashikohej afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara mund të paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre.

Ne Majin e vitit 2018 shoqata “Intelektualet e rinj Shprese” publikoi progres raportin per Procesin e konsultimeve publike në Bashkinë Shkodër¹³. Nga gjetjet e ketij raporti filloi te konstatohej nje progres pozitiv I lehte ku nga 19 kriteret te parashikuara nga ligji vetem 4 zbatoheshin. Aspektet pozitive te progresit ishin si meposhte:

1. *Bashkia Shkodër në website të saj krijoi një rubrikë “Këshillim me publikun” ku publikohen njoftimet për konsultime publike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”*
2. *Publikimi i procesverbaleve shënoi progres pozitiv në krahasim me raportin e parë të monitorimit të realizuar në Prill të vitit 2016 nga ku rezultonte se procesverbalet e takimeve konsultuese nuk mbaheshin në mënyrë të rregullt si dhe nuk publikoheshin*

Në nenin 15 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë përcaktuar afatet për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve ku afati minimal është 20 ditë pune ndërsa për rastin e akteve komplekse ose të rëndësishme ky afat mund të jetë deri në 40 ditë pune. Po ashtu në pikën 2 të Nenit 17 të këtij ligji përcaktohet se: “Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet”. Shoqata “Intelektualet e Rinj, Shprese”, ka ushtruar të drejtën e saj të parashikuar në nenin 21, pika 1\ b e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili parashikon se: “Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cënuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen: pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit”.

Për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore të përcaktuar në nenin 17\2 të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në gjatë procesit të konsultimeve për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afatmesëm 2018-2019 të organizuara nga Bashkia Shkodër me datën 10 Shkurt 2017, IRSH, ka dorëzuar një ankim të Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kundër Bashkisë Shkodër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2017 ka marrë 5 vendime, me objekt shkeljen e legjislacionit për konsultimet publike, nga të cilët me vendimin nr. 54 datë 21. 05.2017, iu dha të drejtë pretendimeve të IRSH-së¹⁴.

Në këtë vendim u konstatuan shkeljet e afateve ligjore nga ana e Bashkisë Shkodër, të cilat edhe sipas citimit të vendimit “Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik , në nenin 17, pika 2,

¹³ <http://irsh.al/wp-content/uploads/2018/05/Progres-raporti-per-konsultimet-Publike.pdf>

¹⁴ Për më tepër ky vendim është pasqyruar në këtë link

http://www.idp.al/wpcontent/uploads/2017/03/Vendim_nr_54-Bashkia_Shkoder.pdf

parashikon afatet taksative të njoftimit për palët e interesuara të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike duke iu dhënë kohen e nevojshme për përgatitje dhe vënë në dizpozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.”

Ne vitin 2021, IRSH si pjese e rrjetit POP prezantoi “Raportin Studimor Pjesemarrja dhe Angazhimi Qytetare ne Nivel Vendor” ku perfshiheshin Bashkite Durrës, Elbasan, Fier, Kamëz, Korçë, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vau i Dejës dhe Vlorë¹⁵

Ne Qershor te vitit 2022, IRSH si pjese e rrjetit POP prezantoi raportin studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” te kryer në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”¹⁶. Raporti doli me rekomandimin per hartimin e nje strategjie me publikun dhe mediat ne funksion te nxitjes se pjesmarrjes se qytetareve ne procesin e konsultimit publik ne Bashkine Shkoder.

Per here te pare Keshilli Bashkiak Shkodërperdori metoden e konsultimit online persa i takon Projekt-Buxhetin afatmesem 2022-2024¹⁷

8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkia; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga nxjerrja e projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe IRSH përgatitën tetë (8) kërkesa për informacion, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore nëpërmjet komunikimit me email shoqëruar dhe dokumentacion shkresor. Në mënyrë të përmbledhur në tabelën mëposhtë janë paraqitur pyetjet e drejtuara Bashkisë Shkodër së bashku me komentet e eksperteve tanë ne lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

¹⁵ https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Studimor_POP_Perfshirja-dhe-Angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor.pdf?fbclid=IwAR1kgBumi9caql7xVkJp7aDgPB3uOEoV1zKPbgNkn0uFgZvKSK3zMda70R0

¹⁶ <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-shkoder/>

¹⁷ https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/permbledhja_e_rekomandimeve_shkoder_2_4018.pdf

Kërkesa për informacion	Pergjigjet e bashkisë Shkodër dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin publik në Bashkinë Shkodër është znj.Griselda Dama Email: griselda.dama@bashkiashkoder.gov.al https://bashkiashkoder.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrie/	U.B. Kryetari I Bashkisë nr.1238, datë 12.10.2023	I realizuar
2. Neni 11 i ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojm të na informoni: 2.1 Mënyrat e njoftimit gjate procesit te konsultimit publik 2.2. Mënyrat e marrjes se komenteve dhe rekomandimeve gjate procesit te konsultimit publik	Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 27 Maj 2024, informon se: <i>Mënyrat e njoftimit gjatë konsultimit publik janë realizuar me anë të: afishimit të njoftimit në ambientet e Bashkisë Shkodër, të Njësive Administrative, si dhe pranë Rajoneve. Gjithashtu, njoftimi për konsultim me publikun është afishuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, si dhe në rrjetet sociale. Mënyra e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik ka qenë nëpërmjet: postës elektronike, me shkrim duke iu dërguar Bashkisë Shkodër, me anë të takimeve/dëgjësave publike të realizuara duke u zbardhur në procesverbal në kohën e zhvillimit të dëgjësës.</i>	Bashkia Shkodër rezulton se kryen në mënyrë të rregullt afishimin e njoftimeve për konsultim me publikun në ambientet e Bashkisë, si dhe pranë Rajoneve. Po ashtu, njoftimet rezultojnë të afishuara edhe në faqen e Bashkisë Shkodër. Komentet dhe rekomandimet merren nëpërmjet postës elektronike, si dhe gjatë dëgjësave dhe takimeve.	I realizuar
3. Neni 16 i ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojm të na informoni: a) A ka patur raste kur eshte zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit b) Nese Po ju lutem na dergoni arsyet si dhe kopje te aktit per te cilin eshte zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit	Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 3 Qershor 2024 informon se: Nuk ka patur raste që është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit.	Proceset realizohen sipas kalendarit dhe nga vëzhgimi rezulton se nuk ka pasur problematika.	I realizuar
4. Në bazë të nenit 17 te ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojm	Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 6 Qershor 2024 informon se: <i>Në lidhje me kërkesën nr. 4 dhe 5, bashkëngjitur gjeni linkun e kalendarit të takimeve të konsultimeve publike për buxhetin 2024 dhe PBA 2024-2026, si dhe procesverbalet e takimeve me Lagjet dhe Njësitë</i>	Sipas vëzhgimit në ambientet e Bashkisë Shkodër dhe në faqen e internetit të Bashkisë Shkodër, rezulton se njoftimet publikohen rregullisht:	I realizuar

<p>të na informoni dhe dergoni:</p> <p>a) Kopje te njoftimit për takime publike</p>	<p><i>Administrative.</i> https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/.</p>	<p>https://bashkiashkoder.gov.al/keshillim-me-publikun/</p>	
<p>5. Në bazë të nenit 18 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe te na dergoni:</p> <p>a)Kopje te Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhes Shtator 2023 – Mars 2024</p>	<p>Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 6 Qershor 2024 informon se:</p> <p><i>Në lidhje me kërkesën nr. 4 dhe 5, bashkëngjitur gjeni linkun e kalendarit të takimeve të konsultimeve publike për buxhetin 2024 dhe PBA 2024-2026, si dhe procesverbalet e takimeve me Lagjet dhe Njësitë Administrative.</i> https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/.</p>	<p>Sipas verifikimit të informacionit në Bashkinë Shkodër, rezulton se kopje të procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës 2023-2024 janë mbajtur dhe publikuar vetëm për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.</p>	<p>Pjesërisht I realizuar</p>
<p>6. Në bazë të nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe dergoni:</p> <p>a) Kopje te Projektakteve të miratuara gjatë periudhes Shtator 2023 – Mars 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar ne zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe</p>	<p>Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 14 Qershor 2024 informon se:</p> <p><i>Projekt/aktet e miratuara gjatë periudhës Shtator 2023-Mars 2024 shoqëruar me 50% të rekomandimeve të pranuar nga ato të dala nga dëgjesat publike të zhvilluara mund t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër:</i> https://bashkiashkoder.gov.al/keshilli-bashkiak/</p>	<p>Nga verifikimet rezulton se nuk ka kopje të projektakteve të shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”</p>	<p>Pjesërisht I realizuar</p>

konsultimin publik			
<p>7. Në bazë të nenit 20 te ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkohm të na informoni dhe te na dergoni:</p> <p>a) Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023</p>	<p>Bashkia Shkodër nëpërmjet emailit të datës 5 Korrik 2024 informon se:</p> <p><i>Më poshtë gjeni linkun për raportin e monitorimit të transparencës dhe këshillimit me publikun, i realizuar nga qendra Faktoje.al. Ky është reporti i vetëm që ne kemi në lidhje me transparencën dhe vendimmarrjen për vitin 2023.</i></p> <p>https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Raporti-i-Monitorimit_10-bashki-Final.pdf</p>	<p>Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Shkodër, rezulton se ekziston vetëm një raport i realizuar nga qendra Faktoje.al. Nga verifikimet, nuk rezulton që detyrimi ligjor për të përgatitur dhe publikuar raportin vjetor nga ana e Bashkisë Shkodër të jetë përmbushur.</p>	<p>Pjesërisht I realizuar</p>
<p>8. Në bazë të nenit 21 te ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkohm të na informoni:</p> <p>a) Nese ka patur ankesa ne lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. b) Nese PO ju lutem na dergoni kopje te ankesave</p>	<p>Bashkia Shkodër nepermjet emailit te dates 5 Korrik 2024 informon se:</p> <p><i>Se nuk ka pasur raste të përsëritjes së fazës së konsultimit.</i></p>	<p>Sipas verifikimeve procesi konsultimit në Bashkinë Shkodër nuk ka patur probematika si dhe ankesa në lidhje me procesin e konsultimit publik.</p>	<p>I realizuar</p>

8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Shkodër

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Shkodër përfshiu 6 zyrtarë (4F/2M), që janë drejtues nga drejtoritë dhe sektorët e ndryshëm të Bashkisë Shkodër, që janë të angazhuar në procese që lidhen drejtëpërdrejtë me njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi kishte për qëllim të evidentojë dhe të analizojë format dhe instrumentet që përdor Bashkia për të afuar qytetarët më pranë vendimmarrjes. Intervistat shërbyen dhe për të shkëmbyer ide dhe sygjerime për përmirësimin e punës në lidhje me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Nga përgjigjet e marra nga intervistat, konsiderohet që procesi i konsultimeve zhvillohet duke respektuar format e parashikuara në ligj. Megjithatë, format e njoftimit dhe përfshirjes së qytetarëve rezulton se nuk njihen mjaftueshëm, dhe ajo që vlen të theksohet është se regjistri elektronik i vendosur nga Bashkia Shkodër nuk përditësohet rregullisht.

Mënyra klasike e njoftimit që njohin zyrtarët e Bashkisë Shkodër është njoftimi nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë dhe këshillit bashkiak, si dhe nga drejtoritë e bashkisë, si dhe nëpërmjet afishimit publik në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.

Nga intervistat rezulton se mungon një sistem vlerësimi i procesit të konsultimit publik i përcaktuar qartë me indikatorë vlerësimi. Për më tepër, zyrtarët lokalë, në funksion të përmirësimit të procesit të konsultimit publik, kërkojnë më tepër mbështetje në asistencë teknike, burime financiare dhe materiale.

8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Në kuadër të këtij studimi u intervistuan 5 anëtarë (3F/2M) të Këshillit Bashkiak. Nga intervistat e zhvilluara me anëtarët e Këshillit Bashkiak rezulton se të intervistuarit e konsiderojnë procesin e konsultimit me një rëndësi të veçantë dhe se pjesëmarrja e publikut është shumë e domosdoshme në procesin e hartimit dhe vendimmarrjes së Këshillit.

Këshilltarët janë në dijeni të rregullores në lidhje me procesin e konsultimit, e cila është njoftuar në momentin që kanë marrë detyrën si këshilltarë. Po ashtu, këshilltarët theksojnë se e njohin bazën ligjore për procesin e konsultimit publik.

Sipas vlerësimit të këshilltarëve bashkiakë, kuadri ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor duhet qartësuar duke përcaktuar cilat mund të jenë përjashtimet sipas tipologjisë së vendimmarrjes apo të vendosen limite (pragje) për të çuar një projekt akt për konsultim. Nuk mund të kushtëzohet çdo vendimmarrje me konsultim vetëm nga natyra e aktit pa marrë parasysh impaktin, të dhënat e mëparshme historike dhe vlerën. Për më tepër, nuk janë të qarta modalitetet e këtij procesi: nëse bëhet një konsultim dhe publiku prezent nuk është dakord, çfarë ndodh? Si dokumentohet? Si është detyrimi për ta reflektuar në relacion? Cilat janë limitet që mund të bëjnë relevant një qëndrim në një konsultim publik?

Në finale, nëse nuk implementohen ndryshime thelbësore apo mekanizma që garantojnë kuantifikimin e sa më sipër, për arsye të garantimit të fleksibilitetit në vendimmarrje, mund të konsiderohet kalimi i procesit online.

Këshilltarët, si një nga arsyet e vështirësive të procesit të konsultimit, listojnë indiferencën e qytetarëve për pjesëmarrje. Ata e vënë theksin tek rritja e angazhimit të pjesëmarrësve dhe nevoja për t'u përqendruar në temat për të cilat realizohet konsultimi publik. Këshilltarët theksojnë se duhen krijuar mekanizma për të trajtuar rastet për konsultim, përjashtimet, por edhe rritjen e angazhimit të publikut në pjesëmarrje. Këshilltarët sugjerojnë që, në funksion të përmirësimit të procesit të konsultimit, të ketë më shumë informacion dhe anketime online për të fituar kohë.

9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi public

9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Me qëllim matjen e nivelit të njohurive dhe të angazhimit të qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Shkodër, gjatë periudhës Maj-Qershor ekipi i projektit përgatiti dhe shpërndau 2 formate pyetësorësh. U përgatit një pyetësor që u shpërnda midis 30 (17F/13M) anëtarëve aktivë në komunitet, përfaqësues të grupeve të interesit, OSHC-ve lokale që kanë informacion rreth procesve të konsultimit dhe/ose kanë marrë pjesë në dëgjesat publike.

Një format I dytë pyetësori, me më pak pyetje u shpërnda online dhe u plotësua nga 104 qytetarë (63F/41M) me qëllim për të matur perceptimin qytetar për konsultimin publik. Në vazhdim do të jepen të dhëna në lidhje me perceptimin qytetar mbi këtë proces të rëndësishëm.

Anketimi u zhvillua me 30 përfaqësues të OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Shkodër, të cilët kishin marrë pjesë në dëgjesat publike. Pyetjet e anketës u përqendruan në të drejtat e pjesëmarrjes, format e njoftimit, pjesëmarrjen në konsultime të ndryshme, dhënien e rekomandimeve, bashkëpunimin me bashkinë, dhe sfidat në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Pjesa më e madhe e të intervistuarve shprehen se kanë informacion si person ose përfaqësues i palëve të interesuara për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon bashkia/këshilli bashkiak për vendimmarrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit. Rrjetet sociale, veçanërisht Facebook, rezultoi të jenë mjeti më i përdorur nga të intervistuarit për t'u njoftuar për njoftimet dhe konsultimet publike.

Megjithatë, konstatohet se shumë nga të intervistuarit nuk kanë marrë pjesë rregullisht dhe nuk kanë kontribuar në procesin e konsultimit publik. Po ashtu, vihet re mungesa e bashkëpunimit me këshillin bashkiak dhe mungesa e rekomandimeve të dhëna nga grupet e interesit. Edhe pse një përqindje e vogël e përfaqësuesve të grupeve të interesit shprehen se kanë dhënë rekomandime, pothuajse të gjithë të intervistuarit theksojnë se rekomandimet e tyre nuk janë marrë asnjëherë parasysh.

Gjithashtu, shumica e të intervistuarve pohojnë se nuk u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, ndikimi që ai ka, afati, vendi dhe mënyra me të cilën mund të paraqesin ose dërgojnë rekomandimet, si dhe adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili është përgjegjës për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve për projekt-aktin.


Disa nga sfidat dhe vështirësitë që hasen në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, qytetarët dhe grupet e interesit i shohin tek pjesëmarrja e ulët dhe pasiviteti i aktorëve. Disa prej

tyre theksojnë se njoftimet bëhen në faqet përkatëse, por komunikimi i mëtejshëm mungon. Në raste të tjera, njoftimet bëhen shumë shpejt dhe lënë pak kohë për të reaguar. Për më tepër, disa të intervistuar shprehën se interesi për këto konsultime ka rënë sepse komuniteti është lodhur nga mungesa e reagimit.

Disa nga rekomandimet e dhëna nga ky grup interesi janë:

- Të gjenden mekanizma që rrisin komunikimin dhe të shtohen mënyrat e informimit të publikut nëpërmjet administratorëve të rajoneve dhe qytetarëve.
- Të ndiqen procedurat dhe njoftohen vërtetë palët e interesuara dhe jo vetëm njerëz për të mbushur sallat.
- Duhet institucionalizuar me mire roli i shoqërisë civile
- Te krijohet një datatbaze e bizneseve
- Njoftime me te hershme ne kohe, kontakt me koordinatoret sipas target grupit

9.2 Perceptimi qytetar (pyetësi online)



Në këtë pyetësor online morën pjesë 104 qytetarë të Shkodrës, nga të cilët 60% ishin femra dhe 40% ishin meshkuj. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve përkiste grupmoshës 30-45 vjeç.¹⁸

Ajo që bie në sy është niveli i lartë i mungesës së pjesëmarrjes, rreth 75% e të anketuarve, në dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak Shkodër.

Për qytetarët që janë përgjigjur pozitivisht pyetjes që kanë marrë pjesë në dëgjesat publike që përbëjnë rreth 25% të të gjithë të intervistuarve, ata janë pyetur mbi mënyrat si janë vënë në djeni të procesit. Përgjigjet mbi njoftimin e procesit janë nga njoftimet në faqen web të bashkisë, lajmërimet individuale dhe

njoftimet nga administrator/kryeplaku.

Të pyetur nëse janë marrë në konsideratë vërejtjet/sugjerimet/komentet e pjesëmarrësve në dëgjesat publike, ata shprehën në pjesën më të madhe se nuk e dinë ose nuk merren parasysh. Në sesionin e fundit qytetarët pyeten mbi besimin se përmirësohet vendimarrja, në dobi të qytetarëve nëse zbatohen me përpikmëri procedurat e konsultimit publik. Të dhënat tregojnë

¹⁸<https://popnetwork.al/detaje-mbi-pyetesorin-perceptimi-qytetar-mbi-njoftimin-dhe-konsultimin-publik-pjesemarrja-sipas-grupmoshave-shkoder/>

një besim të konsiderueshëm nga ana e qytetarëve në përmirësimin e vendimmarrjes përmes zbatimit të procedurave të konsultimit publik. Ky besim është një burim i rëndësishëm për rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e qeverisjes vendore. Për të përfituar nga ky potencial, është e nevojshme që institucionet vendore të përmirësojnë transparencën, të rrisin ndërgjegjësimin dhe të angazhojnë aktivisht qytetarët në këto procese.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Pas analizimit të gjetjeve në lidhje me zhvillimin e procesit të konsultimeve në Bashkinë Shkodër arrijmë në këto konkluzione:

- Mungon në **faqen e internetit** një **informacion i qartë dhe i detajuar** mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimin e debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar ne zbatim te gernes ç) te nenit 9, te VKM Nr. 828, datë 7.10.2015
- Mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të pikes 3 te nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
- Mungon Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023 si nje detyrim ligjore i percaktuar qarte per **organet publike** ne nenin 20 te ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” ku thuhet:

Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

 - a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
 - b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
 - c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
 - ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.
- Mungojne **procedura të unifikuara** te pjesëmarrjes qytetare si një **proces transparent dhe i drejtpërdrejtë** mes adminsitratës së bashkisë, anëtarëve të KB dhe qytetarëve për këshillimin, shkëmbimin e opinionëve për politikën, legjisllacionin dhe normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore.
- Projekt-Akti i hartuar qe ne vitin 2019 “Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat” nuk eshte miratuar ende dhe nuk rezulton qe te planifikohet per te kaluar ne konsultim publik si nje akt mjaft i rendesishem qe rrit besueshmerine ndaj vendimarrjes lokale.

Rekomandime

- Në faqen e internetit duhet të jepet informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, afatet për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, organizimin e debateve publike e deri të miratimi i aktit përfundimtar
- **Projektaktet duhet të shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar** dhe nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë Bashkia Shkodërduhet të paraqes një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të ligjit Nr. 146/2014 **“Për njoftimin dhe konsultimin publik”**
- **Bashkia Shkodër duhet të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes**, ku përfshihet informacion për: a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues; b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; ç) numrin e takimeve publike të organizuara.
- **Nevoitet hartimi i proceseve të standardizuara përmes rregulloreve dhe procedurave vendore të cilat garantojnë** përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes vendore është një nga rekomandimet e rëndësishme. Bashkitë dhe stafet përgjegjëse për realizimin e këtyre proceseve duhet të kenë në dispozicion rregullore dhe procedura standarde dhe të miratuara në këshillin bashkiak të cilat do ta lehtësonin dhe përmirësonin këtë proces.
- **Projekt-Akti i hartuar që në vitin 2019 "Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat"** duhet të nenshtrohet konsultimit publik dhe të miratohet nga Këshilli Bashkiak Shkoder.
- **Ndertimi i mekanizmave të thjeshtë dhe efektiv të pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar** që sigurojnë njerëzve mundësinë për të ndikuar në përdorimin e autoritetit dhe përgjegjësisë lokale.
- **Informimi i qytetarëve:** nepermjet formave interaktive të komunikimit duke përdorur të gjitha kanalet e mundshme të komunikimit të cilat sigurojnë me lehtë shpërndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.
- **Krijimi i blogjeve në websitin e Bashkisë, faqet në mediat sociale** ku qytetarët e kanë lehtësisht të mundshme shprehjen e mendimit tyre duke konsideruar që cdo ze i qytetarëve të Bashkisë duhet të ketë hapsirë të shprehet dhe të degjohet.
- **Rritja e kapaciteteve të personave përgjegjës në bashki** është një domosdoshmëri dhe do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e të gjithë proceseve që lidhen me qytetarët.
- **Sigurimi i burimeve të qendrushme njerëzore dhe financiare:** rekomandohet rritje e kapaciteteve njerëzore, burimeve financiare dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e pjesëmarrjes qytetare.
- **Krijimi partneriteteve me OSHC-te lokale, grupet e interesit në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në vendimmarrje.**

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

Faqja e internetit të Bashkisë Shkodër

<https://bashkiashkoder.gov.al/>

<https://bashkiashkoder.gov.al/aktet-per-te-cilat-eshte-e-detyrueshme-zhvillimi-i-konsultim/>

<https://bashkiashkoder.gov.al/keshillim-me-publikun/>

<https://bashkiashkoder.gov.al/rregjistrat-elektronike/>

Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër.

[https://bashkiashkoder.gov.al/wp-](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_funksionimit_t_k_shillit_bashkiak_shkoder_4406.pdf)

[content/uploads/2023/09/rregullore_e_funksionimit t k shillit bashkiak shkoder 4406.pdf](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_funksionimit_t_k_shillit_bashkiak_shkoder_4406.pdf)

Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat.

[https://bashkiashkoder.gov.al/wp-](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_keshillit_marr_dh_njet_me_publikun_konsultim_dhe_median_f)

[content/uploads/2023/09/rregullore_e_keshillit marr dh njet me publikun konsultim dhe median f](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_keshillit_marr_dh_njet_me_publikun_konsultim_dhe_median_f)
[inal 4387.pdf](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/rregullore_e_keshillit_marr_dh_njet_me_publikun_konsultim_dhe_median_f)

Lista e procesverbaleve të Këshillit Bashkiak Shkodër

[https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-](https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/)
[draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/](https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/)

Projekt-Vendimi për Rishikimin e Programit të Transparencës të Bashkisë Shkodër

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Pr.vendim-Transparenca.pdf>

Mbledhja e rekomandimeve nga Keshilli Bashkiak Shkodërpër prioritetet e komunitetit për projekt buxhetin afatmesëm 2022 – 2024 përmes përdorimit të sondazhit online:

[https://bashkiashkoder.gov.al/wp-](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/permbledhja_e_rekomandimeve_shkoder_2_4018.pdf)

[content/uploads/2023/09/permbledhja_e_rekomandimeve shkoder 2 4018.pdf](https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/permbledhja_e_rekomandimeve_shkoder_2_4018.pdf)

Linqe te tjera:

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

<https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-shkoder/>

<http://irsh.al/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-Transparences-Shqip.pdf>

<http://irsh.al/wp-content/uploads/2018/05/Progres-raporti-per-konsultimet-Publike.pdf>

http://www.idp.al/wpcontent/uploads/2017/03/Vendim_nr_54-Bashkia_Shkoder.pdf

[https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Studimor POP Perfshirja-dhe-](https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Studimor_POP_Perfshirja-dhe-Angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor.pdf?fbclid=IwAR1kgBumi9caql7xVkJp7aDqPB3uOEoV1zKPbgNknOuFgZvKSK3zMda70RO)
[Angazhimi-qytetar-ne-nivel-](https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Studimor_POP_Perfshirja-dhe-Angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor.pdf?fbclid=IwAR1kgBumi9caql7xVkJp7aDqPB3uOEoV1zKPbgNknOuFgZvKSK3zMda70RO)

[vendor.pdf?fbclid=IwAR1kgBumi9caql7xVkJp7aDqPB3uOEoV1zKPbgNknOuFgZvKSK3zMda70RO](https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-Studimor_POP_Perfshirja-dhe-Angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor.pdf?fbclid=IwAR1kgBumi9caql7xVkJp7aDqPB3uOEoV1zKPbgNknOuFgZvKSK3zMda70RO)

12. Anekse

Aneksi 1. Kërkesat drejtuar Bashkisë Shkodër

Aneksi 2. Pyetësi për Intervistat e thelluara me stafin e Bashkisë

Aneksi 3. Pyetësi për Intervistat e thelluara me përfaqësues të Këshillit Bashkiak

Aneksi 4. Pyetësi për Grupet e Interesit

Aneksi 5. Pyetësi online për Qytetarët



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA

TEL/FAX: +355 222 48811

E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al

Datë 23 Maj 2024

Kërkesë për informim nr. 01

Drejtuar: z.Benet Beci, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 6, nenit 9 dhe nenit 10 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni:

- 1) Emrin, kontaktet e Koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe kopje të vendimit të emerimit të tij.
- 2) Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar Projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, germa a) e ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”;
- 3) Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga

President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA

TEL/FAX: +355 222 48811

E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al

Datë 24 Maj 2024

Kërkesë për informim nr. 02

Drejtuar: z.Benet Beci, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 11 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni:

1) Mënyrat e njoftimit gjate procesit te konsultimit publik

- a) me postë elektronike;
- b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;
- c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;
- ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.

2) Mënyrat e marrjes se komenteve dhe rekomandimeve gjate procesit te konsultimit publik

- a) me postë elektronike;
- b) në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.
- c) Tjeter

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA

TEL/FAX: +355 222 48811

E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al

Datë 27 Maj 2024

Kërkesë për informim nr. 03

Drejtuar: **z.Benet Beci**, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 16 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni:

- a) **A ka patur raste kur eshte zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit**
- b) **Nese Po ju lutem na dergoni arsyet si dhe kopje te aktit per te cilin eshte zgjatur ose perseritur faza e konsultimit**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga

President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al
Datë 03 Qershor 2024

Kërkesë për informim nr. 04

Drejtuar: z.Benet Beci, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 17 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe dergoni:

a) **Kopje te njoftimit për takime publike**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al
Datë 04 Qershor 2024

Kërkesë për informim nr. 05

Drejtuar: **z.Benet Beci**, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 18 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe te na dergoni:

- a) **Kopje te Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhes Shtator 2023 – Mars 2024**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al
Datë 10 Qershor 2024

Kërkesë për informim nr. 06

Drejtuar: **z.Benet Beci**, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe dergoni:

- a) **Kopje te Projektakteve të miratuara gjatë periudhes Shtator 2023 – Mars 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar ne zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik”**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al
Datë 26 Qershor 2024

Kërkesë për informim nr. 07

Drejtuar: z.Benet Beci, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 20 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni dhe te na dergoni:

- a) **Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com Website: www.irsh.al
Datë 27 Qershor 2024

Kërkesë për informim nr. 08

Drejtuar: z.Benet Beci, Kryetarë i Bashkisë Shkodër

I nderuar z.Kryetar,

Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” si pjese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Shkodër.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 21 të ligjit Nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojm të na informoni:

- a) Nese ka patur ankesa ne lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik.
- b) Nese PO ju lutem na dergoni kopje te ankesave

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike irsh_centre@yahoo.com, Ju falenderojm për bashkëpunimin!



Me respekt

Saimir Beqiraga
President i IRSH

Aneksi 2. Pyetësi I Intervistave të thelluara me stafin e bashkisë

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike" financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për bashkinë:

Bashkia _____

Nr. i njësive administrative _____

Nr. i banorëve _____

Mbulimi territorial _____

Numri i punonjësve (F/M) _____

1. A ka zhvilluar bashkia juaj standartizim të procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik? (rregullore e brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarte, verifikim)

Po

Jo

2. A ka zhvilluar bashkia juaj ndonjë mekanizëm apo proces të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët? (si psh: dëgjesa publike për PPV, dëgjesa për dhënie të pronave, plane veprimi, dëgjesa për Buxhetimin me Pjesëmarrje, etj)? Nëse po, cilët janë ato për periudhën shtator 2023 – Maj 2024?

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

3. Ndër ta, cilin do veçonit si një ndër mekanizmat që ka rezultuar më efektiv?

4. Prej sa kohësh janë realizuar dëgjesa dhe konsultime publike në bashkinë tuaj?

- Më pak se 6 muaj
- 6 muaj – 1 vit
- 1 – 3 vit
- Mbi 3 vjet (specifiko sa) _____

5. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

- Këshilli Bashkiak
- Kryetari i Bashkisë
- Stafi i Bashkisë
- Organizata jofitimprurëse lokale
- Projekt i realizuar me donatorë
- Tjetër (specifiko) _____

6. A ka vendime, urdhëra të brendshëm të miratuara nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak për programin e transparencës (verifikoni në disa raste është kërkuar të rishikohen programet e transparencës për 2023 - 2024?

Po Jo

7. Nëse po, ju lutem siguronit një kopje elektronike të dokumentacionit për efekt studimi, verifiko nëse plotësohen kërkesat e fushës 6 – Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje?

8. Nëse ka pak informacion dhe ato janë pjesërisht të publikuara në faqen e internetit, pse?

- Mendoni që nuk është e nevojshme
- Nuk ka kapacitete brenda bashkisë për të hartuar një dokumentacion të tillë
- Nuk keni gjetur një praktikë për t'u përshtatur në bashkinë tuaj
- Tjetër

9. Si është i organizuar procesi i njoftimit dhe konsultimit publik (hapat e procesit, përfshirë ideimin e projekt-akteve, njoftimin për konsultimin publik në regjistrin elektronik, numrin e takimeve dhe specifika për çdo takim, ku organizohen, kush merr pjesë, menaxhimi i informacionit dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe ku reflektohen).

10. A ka bashkia juaj Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Kush është përgjegjës për këtë strukturë? (saktësoni drejtorinë nga varet ky pozicion)?

11. Cilat drejtori apo sektore të tjerë të Bashkisë përfshihen në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik?

12. Si e siguron pjesëmarrjen e gjithë grupeve të synuara në proceset me pjesëmarrje?

13. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Regjistri elektronik	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook etc)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale					
Botim në gazetatat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

14. Si merren komentet dhe rekomandimet në procesin e konsultimit publik në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A shpjegohen arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë? Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre? Po Jo

A afishohet/publikohet adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?

Po Jo

A publikohet dhe kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

15. A keni regjistër ose plan vjetor për procesin e vendimmarjes me pjesmarrje (dëgjesat publike)?

Po Jo

16. Si funksionon ky regjistër/plan? A përditësohet sistematikisht? (Verifiko faqen zyrtare e internetit ku publikohen projekt-aktet, që ngarkon me përgjegjësi organet që duhet të publikojnë të gjithë procedurën e konsultimit publik të projekt-aktit)

17. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

18. Është i publikuar ky regjistër/ plan vjetor(online)?

Po Jo

19. A mbahet dhe publikohet procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun?

Publikimi online	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Procesverbali i takimeve	1	2	3	4	5

20. Keni statistika mbi përfshirjen e qytetarëve? Nëse po, specifikoni edhe me shifra (kjo pyetje për koordinatorin e Konsultimit Publik, drejtoritë e tjera nuk kanë statistika, thjesht merrni ndonjë ide sa informacione kanë)?

Total _____

Të ndarë sipas gjinisë _____

- Të ndarë sipas njësive administrative _____
- Organizata jofitimprurëse lokale _____
- Subjekte private _____
- Të rinj _____
- Persona të papunë _____
- Persona me nevoja të veçanta _____
- Të pastrehë _____
- Tjetër _____

21. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik?

Po Jo

22. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi të (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin).

23. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në bashkinë tuaj?

24. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

25. Nëse po/jo shpjegoni si:

26. Cilat do të ishin nevojat për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

- Procedura
- Burime njerëzore
- Burime financiare
- Burime materiale

- Infrastrukturë e përshtatshme
- Asistencë teknike/Trajnime
- Tjetër

27. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Aneks 3. Pyetësi I intervistave të thelluara me grupet e interesit

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara¹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuar për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për grupin e interesit:

Emri _____

Organizatë _____

Biznes _____

Aktivist _____

1. Keni informacion se ju keni të drejta si person ose përfaqësues i palëve të interesuara për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon bashkia/këshilli bashkiak për vendim marrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit?

Po Jo

2. Cilat janë mjetet që jeni njoftuar për njoftimin dhe konsultimin publik? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Njoftime nga rregjistri elektronik/façe web bashkia	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambientet e bashkisë	1	2	3	4	5

¹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook, IG etj)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale	1	2	3	4	5
Botim në gazetat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër, adminstratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar.	1	2	3	4	5

3. Nëse po ju lutem specifikoni ku nga konsultimet e mëposhtme keni marrë pjesë ose keni kontribuar?

Format e pjesëmarrjes	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Dëgjesa për projekt buxhetin vendor 2023-2024	1	2	3	4	5
Dëgjesa për taksat dhe tarifatat vendore	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshime në Planin e Përgjithshëm Vendor	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshimin/tjetërsimin ose dhënien në përodrim të pronave të të tretëve.	1	2	3	4	5
Dëgjesa për miratimin e normave, standarteve e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve, si dhe për mbrojtjen e garantimin e inetresit publik (Dëgjesa për plane veprimi vendore dhe rregullore të ndryshme)	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

4. Nëse keni marrë pjesë, a keni dhënë rekomandime/propozime për Bashkinë ose Këshillin Bashkiak me shkrim ose elektronikisht te koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

5. A keni raste bashkëpunimime bashkinë ose këshillin bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar ose për të organizuar takime publike në favor të grupit që ju përfaqësoni?

Po

Jo

6. Nëse po, rekomandimet tuaja janë marrë parasysh?

Po

Jo

7. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

-
- Këshilli Bashkiak
 - Staf i Bashkisë
 - Organizata jofitimprurëse lokale
 - Projekt i realizuar me donatorë
 - Tjetër (specifiko) _____

8. Në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik që ju keni marrë pjese në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka?
 Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën, ju si palë të interesuara do të paraqesni ose dërgojnë rekomandimet tuaja?
 Po Jo

A u është treguar ose publikuar adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?
 Po Jo

Sa kohe në dispozicion keni për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

9. Mendoni se rekomandimet tuaja janë marrë parasysh? A besoni se konsultimet publike sjellin ndryshime reale, apo bëhen vetëm për procedurë?

10. Në konsultimet publike të organizuara a ju kanë vënë në dispozicion materiale të projekt-aktit për ta shqyrtuar dhe për të dhënë rekomandime? (Nëse po, ju lutem siguroni një kopje të dokumentacionit për efekt studimi)

11. Nëse nuk keni qënë dakord me projekt-aktin dhe keni dhënë rekomandime, komente e vërejtje, a keni patur kohë në dispozicion për ti referuar dhe cila është rruga që keni ndjekur më poshtë?

- keni përgatitur kërkesë-ankesë dhe rekomandime për ndryshim
- keni mbledhur firma të qytetarëve dhe grupeve të interesit për ta kundërshtuar
 - jeni ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin e punës së bashkisë dhe vendim marrjen e këshillit bashkiak.
- keni komunikuar me mediat dhe grupet e interesit
- Tjetër

12. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?

13. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

14. Nëse po/jo shpjegoni si:

15. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë anketim! Kontributi juaj është i vlefshëm për të kuptuar perceptimet publike mbi njoftimin dhe konsultimin publik në nivel vendor. Kjo anketë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy. Ai ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Kukës, Pukë, Vau Dejës) për të pasqyruar perceptimin e qytetarëve mbi njoftimin dhe konsultimin publik në këto njësi të qeverisjes vendore dhe impaktin në vendimarrje përmes konsultimit.

**Ju lutemi, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me sinqeritet dhe duke u bazuar në aq njohuri sa keni. Nëse keni pyetje, ju lutem kontaktoni:
perballjaeofertavepolitike@gmail.com**

Seksioni A: Konsultimi Publik

A1. Bashkia:

This is a question help text.

- Durrës
- Elbasan
- Fier
- Korçë
- Kukës
- Pukë
- Shkodër
- Tiranë
- Vau i Dejës
- Vlorë

A2. 2. Gjinia:

- Femër
- Mashkull

**A3. 3. Moshë:**15-29 vjeç 30-45 vjeç 46-65 vjeç Mbi 65 vjeç **A4. 4. Zona e banimit:**Zonë Urbane Zonë Rurale **A5. 5. Keni informacion për ligjin për konsultimin publik në Shqipëri, ku procesi i njoftimit dhe konsultimit publik me qytetarët, para marrjes së vendimeve duhet të organizohet nga bashkia dhe këshilli bashkiak?**Po Jo **A6. 6. A keni marrë pjesë në dëgjuesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak në dy vitet e fundit?**Po Jo **A7. 7. Nëse JO, përse nuk keni qënë pjesë e konsultimeve?**Nuk e di që kam të drejtë të komentoj, të bëj vërejtje dhe ndryshime në vendimet që merr bashkia dhe/ose këshilli bashkiak. Nuk jam i/e informuar, nuk kam njoftim se kur mbahen konsultimet publike Nuk më intereson Nuk marr pjesë sepse mendimet e mia nuk merren parasysh Tjeter

Tjeter

A8. 8. Nëse PO, specifikoni si jeni vënë në dijeni të procesit?Njoftime nga rregjistri elektronik/façe web e bashkisë Nëpërmjet postës elektronike (e-mail) Lajmërim i publik afishuar në ambientet e bashkisë Lajmërim në mediat audio-vizive lokale Lajmërim në mediat sociale (Facebook, Instagram, X, etj)

Lajmërimi individuale Tjetër (administratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar) **A9. 9. A janë marrë në konsideratë vërejtjet/sugjerimet/komentet tuaja?**Po Jo Nuk e di Pjesërisht **A10. 10. A jeni ankuar ndonjëherë në lidhje me ndonjë aspekt të procesit të konsultimit publik?**Jo, nuk jam ankuar Po jam ankuar por nuk kam marrë përgjigje Po jam ankuar dhe kam marrë përgjigje **A11. 11. A keni besim se përmirësohet vendimarrja, në dobi të qytetarëve nëse zbatohen me përpikmëri procedurat e konsultimit publik?**Po Jo **A12. 12. Në vlerësimet e mëposhtme cilat mendoni se janë probleme të konsultimit publik?**Nuk njoftohemi në kohë në lidhje me një draft vendim që hidhet për konsultim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak bëjnë konsultim publik formal Bashkia dhe Këshilli bashkiak nuk e bëjnë konsultimin publik me grupet e duhura të qytetarëve dhe të interesit Grupet e interesit dhe qytetarët nuk kanë mundësi për të shprehur mendimet e tyre alternative pro ose kunder në lidhje me projekt akte gjatë procesit të konsultimit publik. Edhe kur njoftohem për konsultimet publike ka pak mundësi të diskutojnë të gjithë, mungojnë materialet shoqëruese dhe nuk përcaktohen afate që pas takimeve të paraqiten vërejtjet ose argumentet e qytetarëve. Bashkia ose Këshillit Bashkiak nuk i marrin parasysh rekomandimet e dhëna nga qytetarët dhe grupet e interesit gjatë procesit të konsultimit. Nuk ka interes nga vetë qytetarët të marrin pjesë, nuk duan të përfshihen. **Faleminderit! Rrjeti POP**

RRJETI POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1,
Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>